

Komuna e Podujevës 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Komuna e Podujevës udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Kryetari aktual i kësaj komune është Agim Veliu. Ky është mandat i tretë i tij përderisa LDK e udhëheq këtë komunë qe 15 vite.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetar kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Sipas një studimi të UNDP-së, 95% e qytetarëve të Podujevës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.² Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Podujevës me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të theksuar të kënaqshmërisë nga 32.06 pikë në viti 2012 në -32.41 në viti 2015.³

Vlerësimet e bëra nga Instituti GAP në fund të vitit 2013, tregojnë se problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë: mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe ujit të pijes, mbeturinat, problemet me objektet shkollore, ndotja e lumit dhe vërshimet, mungesa e investimeve në fshatra, objektet banesore pa mirëmbajtje dhe pa infrastrukturë.

¹ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Hapur më 22 qershor 2017)

³ Ibid. faqe 39

Problemet kryesore të Komunës së Podujevës

Problemet në sistemin shëndetësor primar

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Podujevë që disa vite udhëhiqet me ushtrues detyre. Përpos kësaj, QKMF-ja ka mungesë të pajisjeve dhe furnizimeve mjekësore, ndërsa Qendra Emergjente nuk i plotëson kërkesat dhe pritjet. Shumica e laboratorëve të kësaj komune nuk funksionojnë si: laborator i mjekësisë familjare në Podujevë, laborator i fshatin Orllan dhe në fshatin Kërpimëh. Ambulanta në fshatin Murgull ka mungesë të stafit mjekësor dhe për këtë arsye është jashtë funksionit.

Mos-menaxhimi i pronës komunale dhe i borxheve

Sipas Raportit të vitit 2015 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Podujevës nuk ka verifikuar 1/3 e pronave të paluajtshme, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe Udhëzimin administrativ nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin.⁴ Për këtë arsye, Komuna e Podujevës ka dështuar të inkasojë borxhet nga dhënia në shfrytëzim nga këto prona.

Mungesa e transparencës

Në komunën e Podujevës, gjatë këtij mandati nuk është bërë auditimi nga Njësia e Auditorit të Brendshëm (NJAB) për sektorin e Prokurimit Publik. Kjo çështje është theksuar edhe në Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015.

Ndotja e ambientit dhe trajtimi i ujërave të zeza

Në komunën e Podujevës ekzistojnë dy kompani për grumbullimin e mbeturinave, mirëpo pastrimi i deponive të egra nuk bëhet nga këto kompani, edhe pse sipas rregulloreve të aprovuara në kuvendin komunal e kanë për obligim. Ndërsa sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, të gjithë ujërat derdhen në lumin Llap, lum i cili është shndërruar në pikë për derdhjen e ujërave të zeza dhe mbeturinave.

Mungesa e ujit dhe rrjetit të ujësjellësit nëpër fshatra

Mungesa e ujit të pijes sidomos gjatë muajve të verës cilësohet si problem në këtë komunë. Rruga "Fitorja" dhe Dumnica e Poshtme edhe pse janë të kyçura në rrjet të ujësjellësit kanë mungesë të ujit. Ndërsa ka akoma fshatra të cilat nuk janë të kyçura në rrjetin e ujësjellësit si: Zakuti, Dobërdoli, Kërpimëhi dhe fshati Revuq.

⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Podujevës. Qershor 2015. Burimi: <http://bit.ly/2sEUTJv> (Hapur më 22 qershor 2017)

Mungesa e transportit publik

Komuna e Podujevës përveç që nuk ka transport publik nuk ka as stacion të autobusëve. Taksitë dhe kombibusët nuk kanë vend për parking. Sipas, UNDP-së, kënaqshmëria e qytetarëve të Komunës së Podujevës me parkim publik është vetëm 37%.⁵

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Lirimi i hapësirave të uzurpuara

Komuna e Podujevës në shumë zona të saj veçmas në qendër është përcjell me dukurinë e uzurpimit të pronave publike. Në disa raste, mediat kanë raportuar se uzurpatorët janë njerëz që bartin funksione të ndryshme publike. Komuna e Podujevës do të duhej t'i kushtonte rëndësi kësaj çështje duke rikthyer pronat e uzurpuara dhe duke pamundësuar shfrytëzimin e tyre në mënyrë të paligjshme.

Ndërtimi i sheshit të qytetit

Komuna e Podujevës në vitet e fundit ka krijuar një hapësire atraktive në afërsi të lumit "Llap" duke ndërlidhur pjesën e lumit me një shëtitore dhe parkun e qytetit. Kjo konsiderohet pozitive, por jo e mjaftueshme. Komuna akoma nuk ka ndonjë plan për ndërtimin e ndonjë sheshi në qytet. Në ketër vitet e ardhshme komuna do të duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj çështje.


Trendet buxhetore në Komunën e Podujevës (2017)

Komuna e Podujevës në vitin 2017 ka planifikuar 19.3 milion euro buxhet.⁶ Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Podujevës ka pasur një rritje prej afër 3 milion euro të buxhetit. Rritja e buxhetit 2017 krahasuar me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013) është bërë në kategorinë e pagave, investime kapitale dhe mallra dhe shërbime. Për paga në 2013 kanë qenë 9 milion euro, përderisa në 2017 ky buxhet është afër 3 milion euro me i lartë, ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale në 2013 Podujeva ka pasur në dispozicion 5,6 milion euro ndërsa në 2017 ka rreth 5,5 milion euro.

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 82. (Hapur më 23 qershor 2017)


⁶ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2t2dMc2>

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Podujevës 2017




Në bazë të grafikonit të mëposhtëm, shohim se Komuna e Podujevës vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë vitit 2015 ka pasur rënie, për të shënuar ngritje në 2017.

Figura nr.2: Trendet buxhetore në Podujevë 2011-2017



Komuna e Podujevës në vitin 2016 ka pasur të hyra rreth 1.6 milionë euro, apo rreth 400 mijë euro me shume se gjatë vitit 2015.

Tabela nr.3: Të hyrat komunale gjatë vitit 2016 sipas kategorive



Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna duhet të ndërpresë praktiken e deritanishme ku institucionet me rëndësi në shëndetësi dhe arsim janë udhëhequr me ushtrues detyre.
- Komuna duhet të ri-nisë procesin e regjistrimit të pronave dhe të sigurohet se ky proces është gjithëpërfshirës me qëllim të rritjes së të hyrave komunale nga tatimi në pronë.
- Komuna duhet të ketë funksionale njësinë e auditimit të brendshëm dhe të sigurohet se gjitha nismat e saj marrin paraprakisht aprovimin e auditorit të brendshëm me qëllim të shmangies së shkeljeve ligjore.
- Komuna duhet të sigurojë fonde për t'i trajtuar ujërat e zeza veçmas evitimin e derdhjes së tyre në lumin e qytetit.
- Komuna duhet t'i lirojë pronat e uzurpuara publike dhe rastet t'i adresojë në gjykatë.
- Komuna duhet të nisë hartimin e planeve për ndërtimin e sheshit të qytetit.



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world